

VENDIM

Nr.597, datë 10.9.2004

PËR PROCEDURËN PËR DHËNIEN E LEJES SË IMPORTIMIT, EKSPORTIMIT DHE TË PRODHIMIT TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikës të Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Leja e importimit dhe e eksportimit dhe e prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, jepet nga Ministria e Mbrojtjes.
2. Leja e importimit, e eksportimit të lëndëve plasëse për përdorim civil jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim, ndërsa leja e prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil jepet brenda 6 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim.
3. Afati i lejes për importimin dhe eksportimin e lëndëve plasëse për përdorim civil është 1-vjeçar, ndërsa afati i lejes për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorimin civil është 8-vjeçar, me të drejtë rinovimi.
4. Për dhënien e lejes së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, në Ministrinë e Mbrojtjes të krijohet Komisioni i Dhënies së Lejeve, përbërja dhe funksionimi i të cilit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Mbrojtjes.
5. Personi juridik që kërkon të pajset me leje për importimin e lëndëve plasëse, duhet të ketë këto dokumente:
 - a) Dokumentin e regjistrimit në gjykatë si person juridik.
 - b) Dokumentacionin e nevojshëm për llojet dhe sasi të lëndëve plasëse nga uzina prodhuese.
 - c) Dokumentin e vlerësimit të konformitetit dhe dokumentacionin me të dhënat teknike të përbërjes së lëndëve plasëse, të shoqëruara me fotografi.
 - ç) Lejen nga Agjencia Rajonale e Mjedisit për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit.
 - d) Kontratën e shërbimit për ruajtjen fizike dhe transportimin, me të tretë, kur nuk ka licencë për këto shërbime.
 - dh) Lejen nga Ministria e Rendit Publik për magazinimin dhe transferimin e lëndëve plasëse, që do të përdoren gjatë punimeve.
 - e) Kopjen e lejes së mëparshme të importit (nëse ka), faturat dhe listën e lëndëve plasëse, që ka përdorur më parë, deklaratën për lëndët plasëse gjendje në depo dhe cilësinë e këtyre lëndëve.
6. Personi juridik që kërkon të pajset me leje për eksportimin e lëndëve plasëse, duhet të ketë dokumente:
 - a) Dokumentin e regjistrimit në gjykatë si person juridik.
 - b) Kopjen e kontratës së lidhur me subjektin përkatës, të shoqëruar me emërtimet, peshën bruto dhe neto.

c) Listën sipas emërtimeve me të dhënat teknike, të shoqëruara me fotografi, etiketat e përdorimit, të vendosura nga uzina prodhuese.

ç) Certifikatën e përdoruesit të fundit (End-user-it).

7. Personi juridik, që kërkon të pajiset me leje për prodhimin e lëndëve plasëse, duhet të ketë këto dokumente:

a) Dokumentin e regjistrimit si person juridik.

b) Lejen nga Agjencia Rajonale e Mjedisit, për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit.

c) Patentën e prodhimit, me llojet e lëndëve plasëse, sipas vlerësimit të konformitetit (aneksi A, ligji nr.9126, datë 27.9.2003).

ç) Projektin e ndërtimit të uzinës sipas standardeve që kërkohen në rajonin ku do të vendoset kjo linjë.

Gjithashtu duhet të përmbushë edhe këto kritere:

d) Personeli inxhiniero-teknik(mekanikë, kimistë etj) duhet të ketë përvojë pune në fushën e prodhimit të lëndëve plasëse jo më pak se 5 vjet.

dh)Inxhinierët projektues duhet të kenë përvojë pune nga kjo më pak se 3 vjet në këtë sektor dhe të kenë marrë pjesë në projektimin e jo më pa se 3 linjave teknologjike.

e) Të ketë mjetet e nevojshme të transportit dhe të marrë masat për mbrojtjen ndaj zjarrit, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Lëndët plasëse për përdorim civil importohen në Republikën e Shqipërisë vetëm pasi të jenë kontrolluar nga organi i autorizuar nga Ministri i Mbrojtjes, në bazë të procedurave të konformitetit.

9. Leja hiqet në rastet kur:

a) subjekti kryhen vepër penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së importimit, eksportimit a prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil apo që cenon jetën e shëndetin e njeriut;

b) personi fizik ose juridik, gjatë importimit, eksportimit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, shkel rregullat teknike të prodhimit, transportimit, përdorimit dhe të konformitetit të lëndëve plasëse, duke rrezikuar jetën e njerëzve e të kafshëve a mjedisin, si dhe kur nuk përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

10. Tarifat financiare për dhënien e lejeve të importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, caktohen me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Mbrojtjes.

11. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri

Fatos Nano